

# BROSHURË INFORMATIVE PËR VOTUES TË RINJ



INFORMATA LEHTË TË KUPTUESHME







# **BROSHURË INFORMATIVE PËR VOTUES TË RINJ**

**INFORMATA LEHTË TË KUPTUESHME**



Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe  
Misioni i OSBE-së në Shkup  
në vitin 2020 botuan një “Doracak për votues të rinj”.

Në këtë broshurë  
ky doracak është përmbledhur  
në një version lehtë të kuptueshëm.  
Broshura është përgatitur në vitin 2021,  
në kuadër të projektit  
“Mbështetje për qeverisjen demokratike dhe proceset për inkluzion”  
të Misionit të OSBE-së në Shkup në bashkëpunim  
me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të RMV.  
Botimi origjinal i “Doracakut për votues të rinj”  
paraqet versionin përfundimtar dhe zyrtar.

Këtë broshurë e përshtatën  
në format lehtë të kuptueshëm  
vetëpërfaqësuesit nga Shoqata SOLEM dhe ndihmësit e tyre.

Tekstin e përshtatën vetëpërfaqësuesit:

Iva Shuminoska  
Kristijan Ristevski  
Stefan Peshiç

Përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: Fatos Kica

Lekturoi: Ljuljeta Adili-Çeliku

Përpunimi grafik dhe disenjimi: Poliesterdej

Kjo broshurë është në përputhje me standardet evropiane për lexim dhe kuptim të lehtë të informatave.

Mësoni më shumë në: [www.inclusion-europe.eu/easy-to-read/](http://www.inclusion-europe.eu/easy-to-read/)

Përmbajtja, qëndrimet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e këtij botimi

nuk reflektojnë këndvështrimet dhe qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përmbajtja e këtij botimi

mund lirisht të përdoret dhe shumëzohet

për qëllime edukative dhe qëllime tjera jokomerciale,

me kusht që në çdo riprodhim të tillë

të citohen si burime:

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Misioni i OSBE-së në Shkup.

# **PËRMBAJTA:**

---

<b>PJESËMARRJA E TË RINJVE . . . . .</b>	<b>.6</b>
Format e pjesëmarrjes së të rinjve . . . . .	10
Pjesëmarrja politike e të rinjve . . . . .	11
<b>ZGJEDHJET . . . . .</b>	<b>14</b>
Llojet e zgjedhjeve që mbahen në vendin tonë	16
Përgatitja dhe zbatimi i zgjedhjeve . . . . .	20
Sot është dita e zgjedhjeve . . . . .	22
Procesi i votimit . . . . .	26
E drejta e votës dhe mbrojtja e saj . . . . .	29
Inkluzioni ose inkluziviteti . . . . .	31
Personat me aftësi të kufizuar në zgjedhje . . .	33
Pjesëmarrja e grave . . . . .	36
Bëhu ndryshimi që dëshiron ta shohësh . . . .	39
<b>KONTAKTET. . . . .</b>	<b>40</b>

**Ndryshimi i shoqërisë është  
i mundur vetëm nëse në të  
merr pjesë secili.**

# PJESËMARRJA E TË RINJVE

Pjesëmarrja politike dhe qytetarët aktivë janë elementët më të rëndësishëm në shoqëritë demokratike.

**Shoqëritë demokratike** janë shoqëri në të cilat të gjithë qytetarët në vend zgjedhin nëpërmjet zgjedhjeve njerëzit që do të jenë në pushtet.

Për këtë arsye është shumë me rëndësi që të rinjtë të motivohen të marrin pjesë në mënyrë aktive në marrjen e vendimeve.

Të rinj janë të gjithë personat që kanë më shumë se 14 vjet dhe më pak se 29 vjet.

Të rinjtë kanë kërkesa të posaçme që duhet të merren parasysh gjatë hartimit të politikave.

Një nga gjërat më të mira në shoqëritë demokratike është pjesëmarrja e qytetarëve në jetën e përditshme sidomos pjesëmarrja e qytetarëve të rinj.

Pjesëmarrja rinore domethënë pjesëmarrje aktive e të rinjve në:

- vendet ku jetojnë
- organizata rinore
- organizata për të rinj
- organizata rinore ombrellë
- forume rinore politike
- organizata nxënësish





- organizata studentësh
- debate publike
- ngjarje publike
- politikë
- këshilla lokale rinore.

**Organizatë rinore** është organizata në të cilën

numri më i madh i personave që vendosin

se çfarë do të punojë organizata

janë të rinj prej moshës 15 deri në 19 vjeç.

**Organizata për të rinj** është pjesë e një organizate më të madhe e cila punon në interes të të rinjve.

Në organizatat për të rinj anëtarë janë persona të të gjithë moshave.

**Organizata rinore ombrellë** është organizatë

ku bashkohen më shumë organizata rinore

me qëllim të përmbushjes së interesave të caktuara të përbashkëta.

**Forumi rinor politik** është pjesë e

çdo partie politike në të cilën anëtarë janë

të rinj të moshës 18 vjeçare.

**Organizatë nxënësish** është organizata

në të cilën anëtarësohen gjimnazistë dhe gjimnaziste.

**Ngjarje publike** është ngjarje në të cilën mund të marrë pjesë secili.

**Debat publik** është ngjarje në të cilën bisedohet për një temë të caktuar para pjesëmarrësve në këtë ngjarje.

**Përfshirje politike** është kur e shpreh mendimin tënd

për çështje që kanë të bëjnë me ty.

**Këshilla rinore lokale** janë

organe ndihmëse në çdo komunë

ku anëtarë janë të rinjtë.

Të rinjtë në komunë zgjedhin moshatarë

të cilët përfaqësojnë kërkesat e të rinjve në atë komunë.

Përmes pjesëmarrjes aktive rinore

të rinjtë mësohen të:

- marrin përgjegjësi për veprimet e tyre
- marrin përgjegjësi për vendimet e tyre
- japin propozime për përmirësimin e pozitës së të rinjve
- japin ide për përmirësimin e pozitës së të rinjve
- përfshihen në aktivitete të ndryshme në komunë
- përfshihen në aktivitete të ndryshme në vend
- përfshihen në aktivitete të ndryshme në shtete tjera.

Në këtë mënyrë të rinjtë përvetësojnë dhe zhvillojnë

aftësi të reja pa marrë parasysh a janë:

- meshkuj
- femra
- maqedonë
- shqiptarë
- romë
- vlllehë
- serbë
- boshnjakë e
- të tjerë.

Institucionet dhe organizatat ndërkombëtare

vazhdimisht flasin se është shumë me rëndësi

të rinjtë të përfshihen në marrjen e vendimeve.

Institucionet ndërkombëtare janë organizatat si:

- Këshilli i Evropës
- Bashkimi Evropian
- OSBE
- Forumi Rinor Evropian.

OSBE është emërtimi i shkurtë i

Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

Të rinjtë në vendin tonë janë po aq të rëndësishëm sa edhe të tjerët.

Të rinjtë janë të rëndësishëm për proceset që kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë demokratike.

Të rinjtë duhet të marrin pjesë

në marrjen e të gjitha vendimeve që kanë të bëjnë me ata.

Kjo do të thotë se të rinjve duhet t'iu jepet mundësia:

- të marrin qëndrim për vendimet që kanë të bëjnë me ta
- të shprehin mendimin e tyre
- të kenë fuqinë që të pranojnë vendime që kanë të bëjnë me ata
- të kenë fuqinë të refuzojnë vendime që kanë të bëjnë me ata.

Shteti ynë ka miratuar

Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore

që iu mundëson të rinjve të marrin pjesë

në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me ata.

## Format e pjesëmarrjes së të rinjve

Ka 2 forma të pjesëmarrjes së të rinjve:

- e drejtpërdrejtë
- indirekte.

**Pjesëmarrje e drejtpërdrejtë** është kur të rinjtë përfshihen në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me to.

**Pjesëmarrje indirekte** është kur politikat që kanë të bëjnë me të rinjtë i sjell shteti e u prezentohen të rinjve.

Ka 3 forma të pjesëmarrjes rinore:

- pjesëmarrje konvencionale
- aktivizëm institucional
- aktivizëm jashtëinstitucional.

### **Pjesëmarrje konvencionale**

është kur të rinjtë marrin pjesë në zgjedhje.

Ata mund të marrin pjesë si:

- votues
- kandidatë në zgjedhje
- vëzhgues në zgjedhje.



**Aktivizëm institucional** është kur

të rinjtë anëtarësohen në organizata qytetare.

**Aktivizëm jashtë-institucional** është kur

të rinjtë marrin pjesë në protesta.

## Pjesëmarrja politike e të rinjve

Pjesëmarrja politike e të rinjve mund të ndodhë përmes:

- pjesëmarrjes në parti politike
- pjesëmarrjes në vendimmarrje.

Të rinjtë mund të kenë fuqinë për pjesëmarrje politike:

- në komuna
- në vend
- në shtete tjera.

Anëtarësimi në parti politike

nuk guxon të jetë mënyra e vetme për pjesëmarrje politike të të rinjve.

Pjesëmarrja politike e të rinjve duhet të bëhet edhe përmes:

- organizatave qytetare
- pjesëmarrjes aktive rinore
- pjesëmarrjes gjatë miratimit të politikave për të rinj.

Të rinjtë duhet ta kenë mundësinë të marrin pjesë:

- në këshillin rinor lokal
- të votojnë në zgjedhje
- në hartimin e strategjive të ndryshme.

Strategjitë janë plane që përshkruajnë

se si të arrihet një qëllim i caktuar.

Votimi në zgjedhje është mënyra më e shpeshtë e pjesëmarrjes politike.

Është një sfidë e madhe që të rinjtë të binden për të votuar në zgjedhje.

Votimi në zgjedhje është mundësi që të rinjtë të marrin pjesë në jetën politike.

Të rinjtë mund të votojnë në zgjedhje për:

- deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- përfaqësues të komunave ku jetojnë
- kryetar të shtetit.



Të rinjtë mund të kandidohen në zgjedhje e të tjerët të votojnë për ata.

Të rinjtë mund të kandidohen për:

- deputetë në Kuvend
- këshilltarë në komuna
- kryetarë komunash.

Viteve të fundit vërehet se

ka një numër shumë të vogël të të rinjve që votojnë në zgjedhje.

Të rinjtë duan më shumë të marrin pjesë politikisht në mënyra tjera.

Për shtetin është një sfidë e madhe

si t'i bindë të rinjtë të votojnë.

Të rinjtë sot:

- në zgjedhje votojnë gjithnjë e më pak
- gjithnjë e më pak u besojnë politikanëve
- nuk tregojnë interes për politikë.

Të rinjtë janë më pak të interesuar për politikë sepse

kanë përshtypjen se nuk kanë ndikim të vërtetë në vendimet që merren.

Të rinjtë frikësohen se

politikanët do të thonë që i kanë pyetur për mendimin e tyre e më vonë nuk do t'i dëgjojnë.

Programet e partive politike

- shumë pak njohin problemet e të rinjve
- shumë pak trajtojnë problemet e të rinjve
- nuk ofrojnë zgjidhje të mjaftueshme për të rinjtë.

### **Programet e partive politike janë**

plane të partive politike

për atë se çka do të bëjnë nëse fitojnë në zgjedhje.

Fushatat e partive politike karakterizohen me:

- takime qytetarësh
- mitingje politike
- reklamim në televizion
- reklamim në radio
- reklamim në internet.

Për shkak të gjithë kësaj të rinjtë mund mos jenë të interesuar të votojnë në zgjedhje.

Përvojat nga shtetet tjera na tregojnë se të rinjtë janë shumë të rëndësishëm për ndryshimin e shoqërisë ku jetojnë.

Të rinjtë mund të ndihmojnë

ta ndryshojmë shoqërinë në drejtim pozitiv vetëm nëse janë:

- aktivë
- të informuar
- të ndërgjegjshëm.

Zëri i të rinjve është i rëndësishëm për çështje që kanë të bëjnë me ata sepse kanë ide të reja dhe dëshirë të madhe për ndryshim.

Të rinjtë marrin pjesë në ndërtimin e demokracisë dhe paqes.

# ZGJEDHJET

Çdo ndryshim fillon në momentin kur merr vendimin të bësh një zgjedhje.

Zgjedhje bën çdo ditë.

Zgjedh se çdo të veshësh.

Zgjedh se çfarë do të shohësh në televizor.

Zgjedhjen se çfarë shoqërie dëshiron e bën ditën kur voton në zgjedhje.

E drejta për zgjedhje mund të jetë:

- aktive
- pasive.

**E drejta aktive për zgjedhje** është kur voton në zgjedhje.

**E drejta pasive për zgjedhje** është kur

kandidohesh që të tjerët mund të votojnë për ty në zgjedhje.

Në vendin tonë mbahen:

- zgjedhje parlamentare
- zgjedhje presidenciale
- zgjedhje lokale
- votim në referendum.

Zgjedhjet janë:

- të përgjithshme
- të drejtpërdrejta
- të lira.

**Zgjedhje të përgjithshme** mbahen në kohë saktë të përcaktuar.

Në zgjedhje të përgjithshme zgjidhet:

- kush do të udhëheqë me vendin
- kush do ta udhëheqë komunën ku jeton.





**Zgjedhje të drejtpërdrejta** janë kur qytetarët zgjedhin politikanët në mënyrë të drejtpërdrejtë.

**Zgjedhje të lira** janë kur secili qytetar mund vetë të zgjedhë për kënd do të votojë pa presion nga dikush tjetër.

Të gjitha zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të fshehta.

Votim i fshehtë është kur:

- ti nuk ke nevojë t'i thuash askujt se a ke votuar
- ti nuk ke nevojë t'i thuash askujt për kënd ke votuar
- askush nuk mund të insistojë t'i shpjegohesh se pse ke votuar ashtu
- askush nuk mund të insistojë t'i shpjegohesh se pse nuk ke votuar.

Në këtë doracak do të flasim për:

- llojet e zgjedhjeve që mbahen në vendin tonë
- mënyrën e votimit.

# Llojet e zgjedhjeve që mbahen në vendin tonë

## Zgjedhje parlamentare



Në Kuvend miratohen ligjet e shtetit.

Deputetët dhe deputetet

që votojnë për ligje

zgjedhen nëpërmjet zgjedhjeve.

Për këtë arsye deputetët quhen të zgjedhur të popullit.

Qytetarët zgjedhin deputetët në zgjedhje

që ata të munden në mënyrë të pavarur të

miratojnë ligje më të mira

në interes të qytetarëve dhe vendit.

Kur qytetarët do t'i zgjedhin deputetët në zgjedhje

u japin të drejtën të flasin në emrin e tyre.

Deputetët përfaqësojnë qytetarët në Kuvend

për 4 vite.

Deputetët zgjidhen çdo 4 vjet.

Kuvendi ynë përbëhet nga 123 deputetë.



## **Zgjedhje presidenciale**

Kryetari i shtetit përfaqëson vendin dhe është komandant i përgjithshëm i armatës.

Kryetari përfaqëson vendin për 5 vite.

Çdo 5 vjet mbahen zgjedhje presidenciale.

Kandidat për kryetar mund të jetë

secili qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut

që ka mbushur 40 vjet.

Një person mund të zgjedhet për të qenë kryetar vetëm 2 herë.

## **Zgjedhje lokale**

Çdo 4 vjet

qytetarët votojnë për pushtetin lokal në komunën ku jetojnë.

Qytetarët e qytetit të Shkupit në të njëjtën kohë votojnë për:

- pushtetin lokal në komunën ku jetojnë
- pushtetin lokal për Qytetin e Shkupit.

Ditën e zgjedhjeve votojmë për:

- Kryetar ose kryetare të komunës
- listën e këshilltarëve të komunës.

Këshilltarët dhe kryetarët e komunave zgjidhen çdo 4 vjet.

Kur qytetarët zgjedhin

këshilltarët dhe kryetarët e komunave në zgjedhje

atyre u japin të drejtën që në emër të tyre të marrin vendime në komunë.

Pushteti lokal merr vendime për:

- arsimin në komunë
- dhënien e lejeve për ndërtim të shtëpive
- dhënien e lejeve për ndërtim të ndërtesave
- pastërtinë e komunës
- pamjen e komunës
- kulturën në komunë



Kulturën në komunë e përbëjnë:

- bibliotekat
- shfaqjet teatrore që organizohen në komunë
- koncertet që organizohen në komunë.

Pushteti lokal zgjedh:

- drejtorët e shkollave fillore në komunë
- drejtorët e shkollave të mesme në komunë.

Në këtë mënyrë pushteti lokal vendos

si do të jetë arsimi në komunë.

Se cilat persona do të jenë pjesë e qeverisjes

në komunën ku jetojnë

varet nga ajo se:

- a do të votosh në zgjedhjet lokale
- për kënd do të votosh në zgjedhjet lokale.

Ti ditën e zgjedhjeve vendos:

- si dëshiron të duket rruga jote 4 vitet e ardhshme
- sa shpesh do të bëhet pastrimi në komunë
- a do të riparohet rregullisht ajo që është dëmtuar
- a do të ketë më shumë parqe.

## Referendum

Në referendum qytetarët shprehin mendimin e tyre për një çështje të caktuar.

Referendum mund të shpallet për:

- çështje që kanë të bëjnë me gjithë shtetin
- çështje që kanë të bëjnë me një komunë të caktuar.

Në një referendum për çështje që ka të bëjë me gjithë shtetin votojnë të gjithë qytetarët e vendit.

Në vitin 2018 në referendum në nivel shtetëror të gjithë kishin të drejtën të deklarohen se a pajtohen që të ndryshohet emri i shtetit.

Në një referendum për çështje që ka të bëjë me komunën votojnë vetëm banorët e asaj komune.

Në vitin 2017 u mbajt një referendum në nivel lokal në të cilin banorët e atyre komunave kishin të drejtën të deklarohen se a janë kundër hapjes së minierave për ar dhe bakër.

## Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Qeveria përbëhet nga:

- ministrat dhe
- kryetari i Qeverisë.

Kryetarin e Qeverisë e quajmë edhe kryeministër.

Për anëtarët e qeverisë nuk votojmë në zgjedhje.

Ata zgjidhen nga deputetët në Kuvend.

Kur votojmë në zgjedhje parlamentare

zgjedhim se cila parti do të udhëheqë me Qeverinë në 4 vitet e ardhshme.

## Përgatitja dhe zbatimi i zgjedhjeve

Përgatitja dhe zbatimi i zgjedhjeve është në kompetencat e:

- Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve
- Komisioneve zgjedhore lokale
- Këshillave zgjedhorë

Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve shkurtimisht e quajmë KSHZ.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është përgjegjës për:

- përgatitjen e zgjedhjeve
- organizimin e zgjedhjeve
- zgjedhjen e Këshillave Zgjedhorë Komunalë
- vërtetimin e listave të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare
- shpalljen e listave të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare
- vërtetimin e listave të kandidatëve për zgjedhjet presidenciale
- shpalljen e listave të kandidatëve për zgjedhje presidenciale
- zbatimin e zgjedhjeve
- shpalljen e rezultateve nga zgjedhjet parlamentare
- shpalljen e rezultateve nga zgjedhjet presidenciale.

Komisionet zgjedhore komunale shkurtimisht i quajmë KZK.

Komisionet Zgjedhore Komunale:

- zgjedhin anëtarët e këshillave zgjedhorë
- i udhëzojnë qytetarët në cilin vend votojnë
- i vërtetojnë listat e kandidatëve për zgjedhjet lokale
- i shpallin listat e kandidatëve për zgjedhjet lokale
- i zbatojnë zgjedhjet në gjithë territorin e komunës
- i shpallin rezultatet nga zgjedhjet lokale.
- vendosin lidhur me parashtrësat e paraqitura nga votuesit gjatë votimit në vendvotim

Këshillin Zgjedhor shkurtimisht e quajmë KZ.

Këshilli Zgjedhor përbëhet nga

5 anëtarë të cilët i shohim në vendin ku votojmë.

Këshilli Zgjedhor ka për detyrë:

- të zbatojë votimin në një vendvotim
- të mundësojë votim të fshehtë dhe të lirë
- t'i numërojë fletëvotimet në vendvotim
- t'i verifikojë rezultatet nga votimi në vendvotim.

Që të sigurohemi se rregullat e mbajtjes së zgjedhjeve nuk shkilen zgjedhjet i ndjekin edhe:

- përfaqësues të kandidatëve për të cilët votojmë
- vëzhgues
- mediat.

Të gjithë vëzhguesit kanë kartelë identifikimi që të mund t'i dallojmë nga të tjerët.

## Sot është dita e zgjedhjeve

Të drejtë vote kanë të gjithë shtetasit e

Republikës së Maqedonisë së Veriut që kanë mbushur 18 vjet.

Të drejtë vote kanë edhe shtetas të

Republikës së Maqedonisë së Veriut që jetojnë në shtete tjera.

Që të mund të votosh në zgjedhje

duhet të jesh i regjistruar në listën zgjedhore.

Në listën zgjedhore regjistrohen të gjithë qytetarët

e Republikës së Maqedonisë së Veriut që kanë mbushur 18 vjet.

Që të votosh duhet të kesh letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është përgjegjës për listën zgjedhore.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve mund të regjistrojë ose të

fshijë një votues nga lista zgjedhore.

Çdo qytetar mund të kontrollojë

se a është i regjistruar në listën zgjedhore.

Nëse nuk je i regjistruar në listën zgjedhore

por ke letërnjoftim të vlefshëm

duhet të parashtrosh kërkesë në KSHZ për t'u regjistruar.





Mund të kontrollosh a je në listën zgjedhore ose të regjistrohesh në të:

- në zyrën e KSHZ në vendin ku banon
- përmes internetit.

Që të kontrollosh ose që të regjistrohesh përmes internetit mund të kërkosh ndihmë:

- nga një anëtar i familjes
- nga një mik
- nga organizata qytetare.

Kur kontrollon se a je i regjistruar në listën zgjedhore mund të kontrollosh edhe:

- ku duhet të votosh
- adresën e vendit ku duhet të votosh
- a ka vendi ku voton qasje për persona me aftësi të kufizuar fizike.

Që të mund të votosh duhet të kesh me vete:

- letërnjoftim të vlefshëm ose
- pasaportë të vlefshme.

Nëse nuk ke letërnjoftim ose pasaportë nuk do të lejojnë të votosh.

Nëse letërnjoftimi ose pasaporta kanë skaduar nuk do të lejojnë të votosh.

Nuk do të lejojnë të votosh

me dokumente tjera si:

- librezë shëndetësie
- leje për vozitje
- kartelë bankare
- çertifikatë lindjeje.

Vendvotimet hapen në ora 7 në mëngjes ndërsa mbyllen në ora 19 në mbrëmje.


Mund të votosh vetëm një herë.

Nëse ke votuar njëherë, nuk mund të votosh përsëri.

**PROCESI I VOTIMIT ZHVILLOHET  
EKSKLUZIVISHT SIPAS RENDIT  
NË VIJIM:**

1. VERIFIKIMI I DOKUMENTEVE  
PËR IDENTIFIKIM PERSONAL
2. KONTROLLI ME PAJISJE PËR  
IDENTIFIKIM BIOMETRIK
3. KONTROLLIMI DHE  
NËNSHKRIMI NË LISTËN E  
VOTUESVE
4. DHËNIA E FLETËS SË VOTIMIT
5. VOTIMI PAS PARAVANËVE TË  
VOTIMIT
6. VENDOSJA E FLETËVE  
TË VOTIMIT NË KUTITË E  
VOTIMIT






## Procesi i votimit

Ky është procesi i votimit në zgjedhje në Republikën e Maqedonisë së Veriut.


Procesi i votimit zhvillohet sipas hapave në vijim:

1. Votuesit në radhë presin të votojnë njëri pas tjetrit.
2. Kur do të afroshesh për të votuar Këshilli Zgjedhor do ta verifikojë identitetin tënd personal.  
Identitet personal është emri dhe mbiemri yt.  
Kjo do të thotë se një anëtar i Këshillit Zgjedhor do të kontrollojë se a je i regjistruar në listën zgjedhore dhe a voton në emrin tënd.



3. Identitetin personal e vërteton me:

- letërnjoftim të vlefshëm
- pasaportë te vlefshme
- gjurmë gishti.



4. Nuk do të mund të votosh edhe nëse je i/e regjistruar në Listën Zgjedhore në rast se:

- nuk ke letërnjoftim të vlefshëm
- nuk ke pasaportë te vlefshme
- gjurma e gishtit nuk përshtatet me gjurmën e gishtit në listën elektronike zgjedhore.



Gjurma e gishtit në sistemin elektronik zgjedhor është e njëjtë me gjurmën që merr policia kur nxjerrim letërnjoftim.



5. Këshilli Zgjedhor kontrollon nëse ke votuar me herët.

6. Me marrjen e gjurmës nga gishti tregues i dorës së djathtë anëtarët e Këshillit Zgjedhor verifikojnë se:

- ti vërtetë shfrytëzon të drejtën tënde për të votuar
- se nuk ke votuar paraprakisht.
- Nëse nuk ke gisht tregues gjurmë merret nga gishti tjetër i radhës.

7. Në ekranin e monitorit do të paraqitet fotografia jote dhe numri rendor në listën zgjedhore.

Pasi të jetë paraqitur fotografia jote do të nënshkruhesh në listën zgjedhore.

Nëse pajisja nuk funksionon momentin kur ti voton

Këshilli Zgjedhor ka mënyrë se si të ta mundësojë votimin.



8. Do të marrësh një fletëvotim.

Anëtari i Këshillit Zgjedhor:

- do të ndajë 1 fletëvotim
- atë fletëvotim do ta vulosë
- do të ta dorëzojë fletëvotimin
- do të të shpjegojë se si votohet.



9. Voton i vetëm pas paravanit të votimit duke rrethuar numrin rendor para vetëm një kandidati me stilolapsin e vendosur aty.



10. Pasi të kesh rrethuar kandidatin tënd:

- palose fletëvotimin
- fute në kutinë e votimit.

Gjatë votimit personat me aftësi të kufizuar mund të kërkojnë ndihmë nga një person të cilit i besojnë.

Në rast se gabon nuk do të të japin fletëvotim tjetër.

Në këtë mënyrë Këshilli Zgjedhor sigurohet se:

- nuk mund të votosh përsëri
- e drejta jote e votimit nuk është keqpërdorur.



## E drejta e votës dhe mbrojtja e saj

E drejta e votës është e drejtë e garantuar e çdo qytetari.

E drejta jote e votimit të përket vetëm ty.

Askush nuk guxon:

- të ta marrë të drejtën e votës
- të të paguajë që të votosh për një nga kandidatët
- të të shantazhojë që të votosh për një nga kandidatët
- të të kërcënohet që të votosh për një nga kandidatët.

Nëse dikush përpiqet ta bëjë këtë duhet:

- ta lajmërosh te Komisioni Zgjedhor Komunal
- të kërkosh ndihmë nga një prej organizatave të shënuara në fund të kësaj broshure.

Votimi është i fshehtë dhe askush nuk mund të kuptojë se për kënd ke votuar.

Që të sigurohet se votimi është i fshehtë

Të gjitha fletëvotimet janë të njëjta.

Në Komisionin Zgjedhor Komunal mund të raportosh nëse:

- mendon se është shkelur e drejta jote për të votuar
- nuk të është lejuar të votosh.

Atje do të të japin të plotësosh një formular.

Do të të ndihmojnë të plotësosh formularin.

Një kopje të formularit do ta mbajnë ata.


Kopja tjetër e formularit është për ty.

Në afat prej 2 orësh Komisioni

Zgjedhor Komunal do të marrë një

vendim për parashtresën tënde.

Parashtrësën mund ta bësh  
edhe *online* në faqen e internetit  
[www.prigovori.sec.mk](http://www.prigovori.sec.mk).



Nëse nuk pajtohesh me vendimin e tyre  
ke të drejtë të ngresh padi pranë Gjykatës Kushtetuese.  
Mund të kërkosh ndihmë nga një prej organizatave  
të shënuara më fund të kësaj broshure.  
Nëse mendon se është shkelur e drejta jote zgjedhore  
mund ta lajmërosh këtë edhe:

- pranë Zyrës së Avokatit të Popullit
- te vëzhguesit e zgjedhjeve
- te organizatat joqeveritare
- në polici.

Mos hesht nëse mendon se është shkelur  
e drejta jote zgjedhore.

Kundërshto secilin që përpiqet  
ta rrezikojë të drejtën tënde për të votuar.



## Inkluzioni ose inkluziviteti

**Inkluzion** domethënë përfshirje.

Që ta kuptojmë se ç'do të thotë të jesh i përfshirë duhet të kuptojmë ç'nënkupton barazia dhe diskriminimi.

**Barazi** është kur të gjithë jemi të barabartë dhe gëzojmë të drejtat dhe liritë e barabarta.

**Diskriminim** është shmangie ose ndarje e një personi ose një grupi personash pa një arsye të veçantë vetëm se është ndryshe nga ne. Personat që janë të diskriminuar nuk mund t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre si personat tjerë.

Ata mund të diskriminohen për shkak të:

- ngjyrës së lëkurës
- vendit të origjinës
- përkatësisë nacionale
- përkatësisë etnike
- gjinisë
- personave që duan
- gjuhën që flasin
- aftësive të kufizuara
- fesë dhe
- tjetër.




Prandaj përfshirje në procesin zgjedhor nënkupton kur të gjithë qytetarët në vend kanë të drejtën të votojnë pa dallim:

- ngjyrës së lëkurës
- vendit të origjinës
- përkatësisë nacionale
- përkatësisë etnike
- gjinisë
- personave që duan
- gjuhës që flasin
- aftësive të kufizuara
- fesë dhe
- tjetër.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut personave që iu është marrë aftësia e veprimit dhe për të cilët gjykata ka vendosur që nuk mundën lirshëm t'a shprehin vullnetin e tyre nuk u lejohe të votojnë.

E drejta dhe mundësia që të gjithë qytetarët e vendit të votojnë në zgjedhje janë të rëndësishme për demokracinë.

Jo të gjithë qytetarët kanë mundësinë ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre të votës edhe pse kjo e drejtë parashihet me ligj. Prandaj shteti duhet të bëjë gjithçka që mundet që ta parandalojë diskriminimin e një pjese të qytetarëve të vet.



## Personat me aftësi të kufizuar në zgjedhje

Personat me aftësi të kufizuar ballafaqohen me pengesa gjatë realizimit të të drejtave të tyre për të marrë pjesë në zgjedhje.

Ata kanë pengesa pa dallim a janë:

- votues
- kandidatë në zgjedhje
- të punësuar në administratën zgjedhore
- vëzhgues në zgjedhje.

Një nga pengesat në realizimin e së drejtës së votës është mospasja e qasjes në vendvotime.

Nëse në vendin e votimit

ka shkallë e nuk ka

rrugicë për karrocë ose ashensor

personat me aftësi të kufizuar fizike

nuk mund të hyjnë brenda.

Kjo do të thotë se ata aty nuk mund:

- të votojnë
- të jenë vëzhgues
- të jenë anëtarë të këshillit zgjedhor.

Personat me shikim të kufizuar dhe personat e verbër

nuk mund ta lexojnë fletëvotimin.



Që të mund të votojnë vetë duhet t'u përgatiten

fletëvotime në alfabetin e Brajtit.

Gjatë votimit atyre duhet t'u jepet ndihmë

në rast se:

- ata nuk dinë të lexojnë alfabetin e Brajtit
- nuk ka fletëvotime në alfabetin e Brajtit.



Mund të ndodhë që gjatë votimit anëtar i Këshillit Zgjedhor t'ju kërkojë t'i ndihmoni një personi tjetër me aftësi të kufizuar për ta realizuar të drejtën e tij/saj votuese.

Kjo është e lejuar me ligj.

Anëtar i Këshillit Zgjedhor do të të tregojë se çka duhet të bësh.

Gjithmonë duhet të jesh i gatshëm të ndihmosh.

Duhet ta dish se ti nuk voton në vend të personit që i ofron ndihmë.

Ti vetëm i ndihmon që ai/ajo ta shfrytëzojë të drejtën e tij/saj

votuese edhe atëherë kur dëshiron të votojë ndryshe nga ty.

Personat me aftësi të kufizuar sensorike nuk mund t'i ndjekin fushatat parazgjedhore.

Persona me aftësi të kufizuar sensorike janë:

- persona të verbër
- persona me shikim të kufizuar
- persona të shurdhër
- persona me pengesa në dëgjim.

Për këtë shkak ata kanë mungesë informatash.

Prandaj ata e kanë problem të jenë:


- kandidatë në zgjedhje
- vëzhgues në zgjedhje
- anëtarë në këshilla zgjedhore.



Në Republikën e Maqedonisë së Veriut  
deri më tani asnjë person me aftësi të kufizuar  
nuk ka qenë:

- deputet në Kuvend
- kryetar komune
- ministër në Qeveri.

Të rinjë me aftësi të kufizuar  
ballafaqohen me gjithë këto probleme.  
Pjesëmarrje rinore dhe aktivizëm  
nënkupton ndërmarrjen e aktiviteteve  
për të përmirësuar mundësitë e  
personave me aftësi të kufizuar  
të marrin pjesë në procesin zgjedhor.



## Pjesëmarrja e grave

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut

ka shumë gra të reja që mund:

- të kandidohen në zgjedhje
- të zgjedhen në zgjedhje
- të votojnë
- të jenë pjesë e këshillave zgjedhorë.

Edhe pse ligjet parashohin që gratë dhe burrat gëzojnë të drejtat e njëjta në politikë marrin pjesë shumë e më pak gra.

Kështu është në të gjitha shtetet e botës.

Kjo për shkak të perceptimit se gratë duhet:

- të jenë vetëm bashkëshorte dhe nëna
- të kujdesen vetëm për shtëpinë
- më pak të ekspozohen në publik
- më pak të flasin në publik
- suksesi në punë mos t'u duket i rëndësishëm
- e kështu me radhë.

Është me rëndësi të shihet sa gra kanë kandiduar

të jenë:

- deputete në Kuvend
- kryetare komunash
- kryetare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në këtë mënyrë shohim se çfarë duhet të bëhet

që gratë të nxiten për pjesëmarrje më të madhe.

Një nga masat më të mira janë kuotat.



Kuota paraqet një numër paraprakisht të përcaktuar për atë se:

- sa gra përfaqësuese duhet të ketë në një organ
- sa gra duhet të ketë në listën e kandidatëve në zgjedhje.

Ligji thotë se duhet të ketë një numër të caktuar të grave deputete.

Te disa gra problem dhe arsye për diskriminim janë:

- feja
- gjuha
- aftësia e kufizuar
- varfëria
- arsimimi
- mospasja e dokumenteve personale
- mosha.

Votim familjar është kur një anëtar i familjes

i tregon një anëtari tjetër të familjes

për kënd të votojë.

Për shembull votim familjar është kur bashkëshorti

i thotë gruas

ose vajzës për kënd të votojë.

Votim familjar është kur vëllai

i tregon motrës për kënd të votojë.

Votimi familjar është problem më i theksuar në fshatra dhe

më së shpeshti prek gratë.

Vendimin se për kënd do ta japësh votën tënde

duhet ta marrësh vet.

Kur gratë kandidohen në zgjedhje

për ato flitet keq

më shpesh se sa për kandidatët meshkuj.

Mund të vërehen më shumë  
komente ofenduese në Fejsbuk  
ndaj politikanëve të reja dhe grave që luftojnë për të drejta  
sesa ndaj politikanëve meshkuj dhe aktivistëve për të drejta.

Të rinjtë që kandidohen të marrin pjesë në  
procesin zgjedhor nuk guxojnë:

- të nënçmohen
- të ofendohen
- të shqetësohen.

KSHZ duhet të vendosë masa

për t'ua lehtësuar pjesëmarrjen në zgjedhje:

- grave
- personave me aftësi të kufizuara
- bashkësive më të vogla.



## Bëhu ndryshimi që dëshiron ta shohësh

Ne jemi pasqyra e gjithë botës.

Nëse ndryshojmë veten tonë  
do ta ndryshojmë edhe botën.

Kjo porosi duhet të na nxisë ne të gjithëve  
e sidomos të rinjtë.

Të rinjtë janë e tashmja dhe ardhmëria e vendit tonë.

Të rinjtë janë e tashmja dhe e ardhmja e të gjitha shteteve të botës.

Përfshirja e të rinjve kontribuon për  
ndryshime pozitive në shoqërinë në të cilën jetojmë.

Çdokush për vete ka të drejtë të vendosë se çka është më mirë për të.

Zgjedhjet janë e mira më e madhe në demokraci.

Të gjithë ne së bashku votojmë dhe të gjithë vendosim si do të jenë:

- shkollat
- vendet e punës
- shëndetësia
- punësimi i të rinjve.

Vetëm me një qasje të këtillë mund të ndërtohet unitet  
ndërmjet të rinjve dhe institucioneve shtetërore.

Premtimet zgjedhore të kandidatëve duhet:

- të jenë të realizueshme
- t'i përfshijnë pritshmëritë e të rinjve
- t'i përfshijnë nevojat e të rinjve.

Mënyra më e mirë që kjo të realizohet është që  
të rinjtë të nxiten të votojnë në zgjedhje.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

është partner i të rinjve në të gjitha zgjedhjet.

# KONTAKTET

## Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

Telefoni: 02 3244 744

Adresa: Rruga "Shën Kirili dhe Metodi" numër 54  
1000 Shkup

Posta elektronike: [izbori@sec.mk](mailto:izbori@sec.mk)



Republika e Maqedonisë së Veriut  
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

## Shoqatat që sigurojnë mbështetje për personat me aftësi të kufizuar:

Shoqata qytetare për mbështetje të personave  
me nevoja të veçanta **SOLEM** - Shkup

☎ 02/2467-551

✉ [info@solem.org.mk](mailto:info@solem.org.mk)



Shoqata për promovimin dhe zhvillimin e shoqërisë inkluzive

## INKLUZIVA

☎ 076 279 662

☎ 076 279 663

✉ [inkluziva@gmail.com](mailto:inkluziva@gmail.com)

[www.inkluziva.mk](http://www.inkluziva.mk)



## POLIO PLUS – lëvizje kundër hendikepit

☎ 02 2400 544

✉ [polioplus@polioplus.org.mk](mailto:polioplus@polioplus.org.mk)

[www.polioplus.org.mk](http://www.polioplus.org.mk)



Shoqata qytetare **QENDRA E RESURSEVE**  
për prindër të fëmijëve me kërkesa të veçanta

☎ 078 290 246

☎ 078 449 851

✉ [resursen.centar@yahoo.com](mailto:resursen.centar@yahoo.com)

[www.resursencentar.mk](http://www.resursencentar.mk)



Shoqata qytetare **CIVIL** – Qendra për liri

☎ 02 5209 176

✉ [civil@civil.org.mk](mailto:civil@civil.org.mk)

[civil.org.mk](http://civil.org.mk)

